

L I G J
Nr.8510, datë 15.7.1999

**PËR PËRGJEGJËSINË JASHTËKONTRAKTORE TË ORGANEVE TË
ADMINISTRATËS SHTETËRORE**

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 005, datë 23.10.2008)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Përgjegjësia jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore

Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet pasurore dhe jopasurore jashtëkontraktore, që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë, privatë, vendas a të huaj.

Përgjegjësia jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore rregullohet me dispozitat e këtij ligji dhe të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e këtij ligji termat e mëposhtëm kanë kuptimet si vijon:

“Përgjegjësi jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore” kuptohet detyrimi i organeve të administratës shtetërore për të shpërblyer dëmin që këto të fundit i kanë shkaktuar interesave të personave privatë në ushtrim e sipër të funksioneve të tyre publike.

“Rrezik i vazhdueshëm” kuptohet mundësia e përhershme për të shkaktuar dëm, si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të administratës shtetërore.

“Mjete teknike” kuptohen mjete të tilla si semaforët, tabelat e qarkullimit rrugor, ndriçuesit për rregullimin e trafikut ajror, detar etj.

Neni 3

Rastet e përgjegjësisë së organeve shtetërore

(Shtuar shkronja “dh” me ligjin nr. 10 005, datë 23.10.2008)

Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë privatë në rastet që vijojnë:

- a) kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme;
- b) kur kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshme të personave fizikë a juridikë privatë;
- c) kur, megjithëse kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, u shkaktojnë një dëm të pabarabartë subjekteve të cilëve u drejtohet ky veprim a mosveprim;
- ç) kur, për shkak të mosfunksionimit të mjeteve teknike me të cilat organet e administratës shtetërore ushtrojnë veprimtarinë e tyre, persona fizikë a juridikë privatë cenohen në interesat e tyre të ligjshme;
- d) kur u shkaktojnë një rrezik të vazhdueshëm personave fizikë a juridikë privatë.
- dh) kur kryejnë një akt korruptiv gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Neni 4

Përgjegjësia vetjake e punonjësve të organeve të administratës shtetërore

Në ushtrimin e funksioneve shtetërore, punonjësit e organeve të administratës shtetërore nuk përgjigjen për dëmet shkaktuar personave fizikë a juridikë privatë në rastet e parashikuara në nenin 3.

Punonjësit e organeve të administratës shtetërore, përjashtimisht, përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë privatë, kur vërtetohet se ata kanë vepruar me keqbesim.

Në rastet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, organi shtetëror punëdhënës, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit që ka paguar.

KREU II

LLOJET E DËMSHPËRBLIMIT

Neni 5

Kthimi

Kthimi, në kuptimin e këtij ligji, ka të bëjë me kalimin fizik të një sendi ose me rivendosjen e një të drejte, gëzimi i së cilës ishte pezulluar për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të administratës shtetërore të parashikuara në nenin 3.

Neni 6

Shpërblimi

Shpërblimi qëndron në pagimin e një sasive të hollash për të barazpeshuar një dëm, i cili nuk mund të ndreqet në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Neni 7

Zhdukja e shkaqeve që sjellin dëmin

Nëse dëmi shkaktohet nga ndryshimi i një situatë juridike ose faktike, e cila nga ana e saj, e ka origjinën në një akt të administratës shtetërore, organi kompetent i kësaj administrate mënjanon pasojat, nëpërmjet rivendosjes së gjendjes së mëparshme ose, kur

një gjë e tillë është e pamundur, nëpërmjet vendosjes së një gjendjeje të ngjashme.

Zhdukja e shkaqeve që sjellin dëmin nuk zbatohet kur rivendosja e gjendjes së mëparshme ose e një gjendjeje të ngjashme është e pamundur. Ky lloj dëmshpërblimi nuk zbatohet, gjithashtu, kur gjendja ekzistuese është shkaktuar nga një akt administrativ, i cili është bërë i pakundërshtueshëm për të dëmtuarin.

Neni 8

Raportet ndërmjet llojeve të dëmshpërblimeve

Në rastin e shkaktimit të dëmit pasuror, organi kompetent i administratës shtetërore vendos të pranojë kërkesën e të dëmtuarit për kompensim në të holla në vend të zhdukjes së shkaqeve dhe të kthimit, vetëm në rast se kjo zhdukje e shkaqeve dhe kthimi nuk janë të mundur.

Në rastin e shkaktimit të dëmit moral, shpërblimi bëhet në të holla.

Dëmi moral konkuron me dëmin pasuror dhe me dëmet e tjera jopasurore.

KREU III

NOCIONET THEMELORE TË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE

Neni 9

Përfshirja nga përgjegjësia

Organi i administratës shtetërore nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij, në qoftë se dëmi nuk do të mund të shmangej edhe nëse do të ishte treguar kujdesi i duhur gjatë ushtrimit të funksioneve shtetërore, në pajtim me rrethanat.

Përfshirja e mësipërm nuk zbatohet në rastin e mosfunksionimit të mjeteve teknike.

Neni 10

Fitim i munguar

Në shpërblimin e dëmit përfshihet në çdo rast, fitimi i munguar, si dhe dëmi jopasuror, në përputhje me nenin 12.

Neni 11

Faji i të dëmtuarit

Në rast se, përveç veprimeve dhe mosveprimeve të organit të administratës shtetërore, në shkaktimin e dëmit kanë ndikuar edhe veprimet ose mosveprimet e të dëmtuarit, masa e dëmshpërblimit, që duhet të jepet varet nga masa në të cilën dëmi është shkaktuar edhe nga i dëmtuari.

Roli i palës së dëmtuar në shkaktimin e dëmit dhe masa e dëmshpërblimit që paguhet në këtë rast, përcaktohen nëpërmjet vlerësimeve të ekspertit, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 12
Dëmet jopasurore

1. Në rastet kur dëmi ka të bëjë me cenimin e paprekshmërisë trupore, të shëndetit, të lirisë ose të personalitetit, shpërblimi bëhet në të holla, duke mbajtur gjithnjë parasysh rolin e të dëmtuarit në shkaktimin e dëmit, sipas nenit 11.

2. Pretendimi për dëmet jopasurore, të treguara në pikën 1 të këtij neni, bie kur është e mjaftueshme zhdukja e shkaqeve në pajtim me nenin 6, si dhe kur i dëmtuari është dëmshpërblyer në një mënyrë tjetër.

Neni 13
Pretendime të të dëmtuarve jo drejtpërdrejt

1. Në rastet e vdekjes, cenimit të paprekshmërisë trupore ose të shëndetit, si dhe në rastin e heqjes së padrejtë të lirisë, si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të organeve të administratës shtetërore, të tretit, të cilit i dëmtuari ka qenë i detyruar t'i bëjë shërbime në shtëpi ose në punën e tij, i paguhet një dëmshpërblim në të holla për dëmin që i shkaktohet nga shërbimet e perealizuara.

2. Në rast se është shkaktuar vdekja e një personi, për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të organeve të administratës shtetërore, këto të fundit janë të detyruara të dëmshpërblejnë shpenzimet e varrimit të atij që ka detyrimin ligjor për t'i paguar ato.

3. Kur i vdekuri, në çastin e shkaktimit të dëmit, ka qenë ligjërisht i detyruar për t'i dhënë një të treti detyrim ushqimor ose mund t'i vihej një detyrim i tillë, dhe kur i treti ka mbetur pa këtë detyrim ushqimor, si rezultat i vdekjes së të detyruarit, atëherë atij i dëmshpërblehet dëmi nëpërmjet caktimit të një pensioni në të holla.

Detyrimi për shpërblim të kësaj natyre qëndron edhe kur i treti, në çastin e shkaktimit të dëmit, ka qenë i zënë, po jo i lindur.

4. Edhe për pretendimet e të tretëve verifikohet roli i vetë të dëmtuarit në shkaktimin e dëmit, sipas nenit 11.

Neni 14
Debitorët solidarë

Kur përgjegjës për shkaktimin e dëmit janë disa organe të administratës shtetërore, secili prej tyre mban përgjegjësi për të gjithë dëmin. Ata përgjigjen kundrejt të dëmtuarit si debitorë solidarë.

Neni 15
Kërkimi i dëmshpërblimit

Në rastet kur organi i administratës shtetërore shkakton një dëm, si rezultat i një akti ose veprimi të kundërligjshëm të një organi tjetër, organi i parë mund t'i kërkojë shpërblimin organit të dytë, në qoftë se nuk parashikohet ndryshe nga ligji.

Neni 16
Pushteti i deleguar

Në rast se subjekti, që shkakton dëmin, nuk është organ i administratës shtetërore, por vepron në bazë të autorizimit nga pushteti publik, përgjegjës në mban autoriteti publik, i cili ka kompetencën fillestare. Në rast se subjekti i deleguar e shkakton dëmin për faj të tij, autoriteti delegues mund të kërkojë dëmshpërblim, sipas nenit 15.

Neni 17
Afatet

Kërkimi i shpërblimit për dëmet e shkaktuara nga organet e administratës shtetërore parashkruhet brenda 3 vjetësh nga çasti kur i dëmtuari merr dijeni për dëmin dhe organin që e ka shkaktuar atë.

Në rastin kur dëmi shkaktohet nga ndryshimi i situatës, në vend të marrjes dijeni për dëmin, futet koncepti i marrjes dijeni për rrethanat, të cilat e kanë bërë situatën të kundërligjshme.

KREU IV
PROCEDURAT PËR KËRKIMIN DHE PAGIMIN E DËMSHPËRBLIMIT

Neni 18

Procedurat për kërkimin dhe përmbushjen e dëmshpërblimit bëhen në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 19

Vendimi i organit të administratës shtetërore për njohjen e përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit, për pagimin e dëmshpërblimit përkatës dhe të masës së tij, përbën titull ekzekutiv.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 20

Të gjitha detyrimet për shkaktimin e dëmit, që organet e administratës shtetërore kanë kundërsht personave fizikë a juridikë privatë, në rast se nuk paguhen menjëherë për pamundësi financiare, futen si zë i veçantë në ligjin e buxhetit të shtetit në vitin pasardhës.

Neni 21

Në fund të çdo viti financiar, organet buxhetore dorëzojnë në Ministrinë e Financave, së bashku me kërkesën për financim nga buxheti i shtetit edhe kërkesën për sigurimin e fondeve buxhetore për detyrimet e tyre ndaj personave privatë.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2424, datë 22.7.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani